



Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë / /2016

**Drejtuar : Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë
Z. Edi RAMA**

TIRANE

Në mënyrë të përsëritur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, është prezantuar prej individëve të ndryshëm apo dhe përfaqësues të shoqatave të krijuara nga familjarët, tokat e të cilëve janë përmblytur nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë, çështja e trajtimit të problemeve të tyre, sikurse përcaktuar në Dekretin Nr.886, Datë 12.07.1994 *“Për dhënie kredie banorëve të zonave të përmblytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”*, Udhëzimin Nr.1, Datë 20.02.1995, *“Për kriteret e dhënies së kredive banorëve të zonave të përmblytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”*, ndryshuar me VKM Nr.125, Datë 26.02.1996, *“Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.1, Datë 20.02.1995, “Për kriteret e dhënies së kredive banorëve të zonave të përmblytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”, VKM Nr.716, Datë 18.12.1995, “Për sistemin e familjeve të Fshatit Fajzë të Rrethit Has në tokat disponibël të Kurorës së Tiranës”*, ndryshuar me VKM Nr.531, Datë 27.01.1997, *“Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.716, datë 18.12.1995”*, dhe VKM Nr.413, Datë 27.07.2000, *“Për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet që u janë përmblytur tokat nga Ujëmbledhësi i Hidrocentralit të Fierzës”*.

Krahas akteve ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.306, Datë 30.06.1994, “*Për masat që do të merren për zonat e përmytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë*”, shfuqizuar me VKM Nr.391, Datë 21.02.2008, “*Për shpalljen “Zonë ekonomike”, në Spitallë, Durrës*”, ndryshuar me VKM Nr.72, Datë 28.01.2015, “*Për shpalljen e zonës*

ekonomike, me statusin “Zonë e lirë”, në Spitallë, Durrës, dhe për një ndryshim në Vendimin Nr.391, Datë 21.02.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike”, në Spitallë, Durrës”, ka përcaktuar masat për trajtimin e familjeve, tokat e të cilave janë përmbytuar nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë.

Organet e ngarkuara për zbatimin e akteve të lartpërmendura, në përgjigje të kërkesave të Institucionit “Avokati i Popullit”, apo takimeve të zhvilluara, kanë shprehur qëndrime të cilat jo vetëm nuk kanë mundur të justifikojnë zvarritjen tej çdo afati të arsyeshëm të zgjidhjes së kësaj çështjeje, por nuk japin as zgjidhje shteruese problemeve që kanë familjet, tokat e të cilave janë përmbytuar nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë.

Funksionimi i organeve të ngarkuara për zbatimin, ndjekjen dhe kontrollin e akteve të lartpërmendura, konstatohet se, nuk vjen në respektim të parimit të ligjshmërisë, parimit të dhënies së ndihmës aktive, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe i efijencës, të parashikuara në nenin 4, 10, 15 dhe 18, të Kodit të Procedurës Administrative dhe detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 dhe 2 të këtij Kodi.

Qëndrimin e derisotëm të organeve të caktuara për zbatimin, ndjekjen dhe kontrollin e akteve të lartpërmendura, e vlerësojmë në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse garantuar në sanksionimin e kryer në nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), si rrjedhojë e mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për zbatimin e akteve ligjore në fjalë.

Në korespondencën bashkëlidhur kësaj shkrese, të zhvilluar me një numër organesh dhe institucioneve, konstatohet se, çështja e prezantuar nuk do të mund të zgjidhet në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, pa ndërhyrjen tuaj z.Kryeministër.

Për shkak të mosrespektimit në mënyrë rigoroze, të së drejtës të njohur familjeve, tokat e të cilëve janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë, mbi bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Institucioni i Avokatit të Popullit mbështetur në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOJME

Marrja e masave dhe kryerja e veprimeve sa më të shpejta të mundshme, për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet, tokat e të cilëve janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform parashikimit të kryer në nenin 19 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të shkresës nr.1737/1 Prot, datë 21.03.2016, të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3097/1 Prot, datë 27.05.2016, të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.1737/4 Prot, datë 01.09.2016, të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.6058/1 Prot, datë 23.05.2016, të Bashkisë, Lushnje, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3694/1 Prot, datë 24.05.2016, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.5629/1 Prot, datë 27.07.2016, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2800/1 Prot, datë 19.04.2016, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2112/1 Prot, datë 30.03.2016, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3898/3 Prot, datë 15.04.2016, të Ministrisë së Financave, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3898/1 Prot, datë 30.03.2016, të Ministrisë së Financave, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.6526/1 Prot, datë 17.05.2016, të Ministrisë së Financave, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.9896/1 Prot, datë 01.08.2016, të Ministrisë së Financave, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3/1-I Prot, datë 30.03.2016, të Prefektit të Qarkut, Kukës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.226-I Prot, datë 31.03.2016, të Prefektit të Qarkut, Kukës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.266-I Prot, datë 11.04.2016, të Prefektit të Qarkut, Kukës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.24-5/69 Prot, datë 12.05.2016, të Prefektit të Qarkut, Kukës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3/3-I Prot, datë 13.07.2016, të Prefektit të Qarkut, Kukës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.109 Prot, datë s'ka.2016, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.1745/1 Prot, datë 13.04.2016, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3513/1 Prot, datë 20.07.2016, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2085/2 Prot, datë 27.05.2016, të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2108/3 Prot, datë 20.04.2015, të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.3450/1 Prot, datë 23.05.2016, të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2108/1 Prot, datë 29.03.2016, të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Shkresë nr.K3/I58-6 Prot, datë 15.10.2015, të Avokatit të Popullit drejtuar Prefektit të Qarkut, Tiranë.

Kopje të shkresës nr.1646/1 Prot, datë 25.03.2016, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2701/1 Prot, datë 21.01.2016, të Prefektit të Qarkut, Kukës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2826/1 Prot, datë 27.07.2016, të Prefektit të Qarkut, Kukës, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.4542/1 Prot, datë 28.07.2016, të Zëvendëskryeministrit, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, qytetari Sherif Kastrati ka paraqitur ankesë në të cilën ka ngritur shqetësimin e e mostratimit të familjes së tij me tokë bujqësore, konform VKM nr.306, datë 30.06.1994 dhe VKM nr.413, datë 27.07.2000. Nga aktet e dërguara bashkëlidhur ankesës konstatohet se Drejtoria që ju përfaqsoni ka në proces trajtimi problemin e këtij shtetasi si dhe gjithë banorëve të Fshatit Brut, Komuna Gjinaj, Rrethit Has, të cilëve ju është përmbytur toka nga ndërtimi i H/C Fierzë.

Meqënëse problemi që parashtron ankuesi është në kompetencën e E Drejtorisë që Ju përfaqsoni, në mbështetje të nenit 17/c të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, po ju dërgojmë për kompetencë trajtimin e ankesës së shtetasit Sherif Kastrati si dhe aktet bashkëngjitur ankesës së tij.

Pas përfundimit të trajtimit që do t’i bëni këtij akti, ju lutemi bëni me dije për hapat që keni ndërmarrë në realizimin e të drejtës së pretenduar nga ankuesi.

Bashkëngjitur, ju dergojmë kopjo të akteve si mëposht:

Shkresë nr.869 Prot, datë 10.03.2011 e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Qarkut Kukës.

Shkresë nr.353 Port, datë 12.04.2011 e Këshillit të Qarkut Kukës, SAMT, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Në mënyrë ngritura prej për mbrojtjen e interesave të ligjshme të rrjedhura shtetasi Ilir Avdiaj ka paraqitur një ankesë, në të cilën parashtrohet shqetësimi i moszgjidhjes së çështjes të trajtimit të familjeve, prona e paluajtshme e të cilave është përmbytur nga ndërtimi i Liqenit të Hidrocentralit të Fierzës. Ky rast është vetëm një nga ankesat e shumta, që janë paraqitur në institucionin tonë lidhur me këtë problematikë..

Sikundër ankuesi shkruan dhe siç vërtetohet nga dokumentat bashkëngjitur ankesës, ai dhe vëllai i tij Petriti, janë trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit Azgan Avdiaj, të cilit i janë njohur sipas të gjitha kriterëve ligjorë, një sipërfaqe toke prej 15 dynym dhe një shtëpi dykatëshe me përmasa 12x5 m, prona këto të ndodhura në fshatin Berishë, të ish komunës Bytyç, të rrethit Tropojë, të përmbytura aktualisht nga Liqeni i Hidrocentralit të Fierzës.

Megjithëse ankuesi shprehet se ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin për të përfituar kompensimin që i takon, sot e kësaj dite nuk është ndërmarrë asnjë veprim për këtë qëllim nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Në këto kushte, ai ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Bazuar në aktet përkatëse nënligjore të miratuara për trajtimin e kësaj çështjeje, i jemi drejtuar respektivisht institucioneve që drejtohen prej Jush, për dhënien e shpjegimeve lidhur me trajtimin e kësaj ankese individuale.

Përkatësisht i jemi drejtuar në përputhje me përcaktimet e dhëna në VKM nr.413, datë 27.07.2000 “Për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet që u janë përmbytur tokat nga ujëmbledhësi i hidrocentralit të Fierzës”, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe Prefektit të Qarkut Kukës.

Në kërkesën tonë për shpjegime kemi theksuar se, nga informacione që kemi arritur të kemi prej shqyrtimit të ankesave të ngjashme të mëparshme në institucionin tonë, jemi vënë dijeni të faktit se, në datë 05.01.2003 është ngritur një grup ndërministror për këtë çështje, por që ende nuk ka dhënë zgjidhje konkrete. Ndërkohë, kemi kërkuar të informohemi nga institucionet respektive, sipas kompetencave përkatëse, mbi:

- Situatën në të cilën ndodhet trajtimi i çështjes së ankuesit, prona e të cilit është përmbytur nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Hidrocentralit të Fierzës.
- Shkaqet që justifikojnë moszgjidhjen e deritanishme të çështjes së ankuesit.
- Mundësitë ekzistuese për zgjidhjen sa më parë të kësaj çështjeje, të parashtruar nga z. Avdiaj.

Pas kërkesave të përsëritura për shpjegime kemi arritur të kemi përgjigjet përkatëse, por që nuk i referohen konkretisht pyetjeve të adresuara nga ana jonë për këtë problematikë.

Konkretisht na rezulton se:

1. Në përgjigjen e kthyer nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me anë të shkresës nr.1737/1 datë 21.03.2016, thuhet telegrafikisht që kjo ministri nuk e ka fushën e përgjegjësisë shtetërore të saj, trajtimin e familjeve me toka të përmytyra nga ndërtimi i hidrocentraleve.
2. Në përgjigjen e dhënë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, me shkresën nr.2108/1 datë 29.03.2016 dhe të përsëritur me shkresën nr.2108/3 datë 20.04.2016, thuhet se, baza ligjore për trajtimin e familjeve prona e të cilëve është përmytur nga ndërtimi i H/C Fierzë, janë VKM nr.306 datë 30.06.1994 dhe VKM nr.431 datë 27.07.2000. Në vazhdim thuhet shprehimisht se: *“Nëpërmjet tyre, përcaktohej trajtimi i këtyre familjeve me tokë bujqësore në zonat fushore të vendit, si dhe ndihma të tjera për t’u sistemuar në banesa. Në zbatim të këtyre vendimeve, nga institucionet qendrore dhe vendore, janë saktësuar sipërfaqet e përmytyra nga H/C Fierzë, për çdo trung familje, fshat, komunë dhe në nivel rrethi.*
Po kështu, janë përcaktuar edhe sipërfaqet ku do të trajtoheshin me tokë këto familje, në disa rrethe të zonës bregdetare, sipas listave të përgatitura nga Ministria e Punëve të Brendshme.
Gjatë periudhës 1994 dhe në vazhdim, janë zhvendosur disa qindra familje nga këto rrethe për në zonën fushore të vendit.
Megjithatë, marrë shkas nga ankesat e herë pas herëshme të këtyre banorëve, janë bërë rregullimet përkatëse nëpërmjet ligjit nr.171/2014 “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore”.
Ndërsa në zbatim të tij, është miratuar VKM nr.337 datë 22.04.2015, “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”. Në çdo rast, plotësimi i dokumentacionit të pronësisë bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore përkatëse”.
3. Në përgjigjet e dhëna nga ana e Prefektit të Qarkut Kukës, me shkresat nr.3/1-I datë 30.03.2016 dhe nr.226/1 datë 31.03.2016, si dhe nr.266/1 datë 11.04.2016, sqarohet ndër të tjera se: *“Me miratimin nga Parlamenti të Ligjit nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, procedurat për kthimin dhe kompensimin e pronës i ka kryer Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të pronave përfshi dhe tokat e përmytura nga H/C Fierza, e cila ka funksionuar në të gjitha qarqet deri më 31.12.2011”.* Ky ligj, sipas përgjigjes, ka përfshirë edhe pronat e përmytura nga H/C Fierza. Në vazhdim në përgjigje thuhet shprehimisht se, *“Në lidhje me ankesën e z. Ilir Avdiaj dhe shumë qytetarëve të tjerë që nuk iu është zgjidhur çështja e trajtimit të pronave të paluajtëshme të përmytura nga H/C Fierzës, është mungesa e dokumentacionit për të aplikuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”.*
4. Në shkresën e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1745/1 datë 13.04.2016, çështja i referohet për dhënie informacioni Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizimeve. Ndërkohë në një përgjigje

të kthyer nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, me shkresën e protokolluar në institucionin e Avokatit të Popullit me nr.K3/I10-14 datë 20.04.2016, konfirmohet se zgjidhja e kësaj problematike nuk ka qënë dhe nuk është në kompetencë të saj.

5. Në përgjigjet e dhëna nga ana e Ministrisë së Financave me shkresat nr.3898/1 datë 30.03.2016 dhe nr.3898/3 datë 15.04.2016, sqarohet se kjo ministri ka marrë të gjitha masat për zgjidhjen e këtyre problemeve sipas kërkesave që institucionet drejtëpërdrejtë përgjegjëse kanë paraqitur. Në këtë këndvështrim, në përgjigje shprehet gatishmëria për të kontribuar brenda kuadrit ligjor, për zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike.
6. Në përgjigjet e kthyer nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me shkresat nr.2112/1 datë 30.03.2016 dhe nr.2800/1 datë 19.04.2016, ka një qëndrim të paqartë. Ndërsa në shkresën nr.2112/1 datë 30.03.2016 thuhet se, për këtë çështje duhet t'i drejtohem Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë si institucioni përgjegjës, me shkresën tjetër nr.2800/1 datë 19.04.2016 vihem në dijeni se, kjo ministri i është drejtuar "KESH" sh.a, për të na dhënë informacion mbi problematikën e ngritur.
7. Në përgjigjen e kthyer nga ana e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me anë të shkresës nr.2086/2 datë 27.05.2016, thuhet telegrafikisht se kjo çështje është jashtë fushës së mbulimit të kësaj fushe.

Duke qënë se aktualisht në institucionin e Avokatit të Popullit, po shqyrtohen njëkohësisht disa ankesa individuale, por edhe ankesa të shoqatave që mbrojnë interesat e familjeve, të cilave ju janë përmbytur pronat nga hidrocentrali i Fierzës, evidentohet nga praktikat e ankesave të tjera në shqyrtim, një tjetër përgjigje e kthyer nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me anë të shkresës nr.3097/1 datë 27.05.2016, ku thuhet shprehimisht se:

"Çështja e familjeve të përmbytura nga H/C Fierzë, është një problem për të cilin janë bërë zgjidhje të pjesshme duke trajtuar vetëm një pjesë të këtyre familjeve".

Në vazhdim citohet kuadri ligjor për zgjidhjen e kësaj çështjeje ku përfshihet, VKM nr.306 datë 30.06.1994, i shfuqizuar me VKM nr.391 datë 21.02.2008 i Këshillit të Ministrave "Për shpalljen "zonë ekonomike", në Spitallë, Durrës", i ndryshuar, VKM nr.413 datë 27.07.2000, Ligji nr.9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar. Po sipas kësaj përgjigjeje:

*"Sipas kuadrit ligjor në fuqi, kompensimi fizik ose në të holla i familjeve, tokat e të cilëve janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës, **mund të bëhej** sipas dispozitave të ligjit nr.9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar. Koncretisht pika 2, e nenit 6 të tij parashikon se: "Subjektet e shpronësuar, pronat e të cilëve janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve, trajtohen sipas dispozitave të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur kanë përfituar sipas ligjit, "Për shpronësimet për interes publik", dhe toka vlerësohet si truall industrial".....*

Në fund theksojmë se, zgjidhja e problemit të familjeve me toka të përmbytura nga ndërtimi i H/C të Fierzës është shumë kompleks dhe nuk i

përket fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.

Duke patur një informacion që vjen nga shumë institucione njeherësh, përshtypja e parë që të krijohet është se kemi të bëjmë me një çështje shumë komplekse. Megjithatë, ajo cfarë mund të konstatohet lehtësisht në këtë trajtim dhe që përbën thelbin e çështjes është fakti se:

- Nga i gjithë legjislacioni i miratuar për zgjidhjen e çështjes së trajtimit të familjeve, tokat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës, sot, akti nënligjor bazë për trajtimin e kësaj problematike, mbetet VKM nr.413 datë 27.07.2000 “Për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet që u janë përmbytur tokat nga ujëmbledhësi i Hidrocentralit të Fierzës”. Ky konkluzion vjen pasi sikurse rezulton, VKM nr.306 datë 30.06.1994, është shfuqizuar me VKM nr.391 datë 21.02.2008, “Për shpalljen “zonë ekonomike”, në Spitalë, Durrës”, i ndryshuar. Efektivisht në VKM nr.391 datë 21.02.2008, nuk trajtohet në asnjë pikë çështja e trajtimit të familjeve, tokat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës. Nga ana tjetër, ligji nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.133 datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Ligji në fuqi “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, nuk e trajton në përmbajtjen e tij zgjidhjen e çështjes së familjeve, tokat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës.
- Vërehet një lloj konfuzioni në kuptimin e rolit përkatës dhe të përgjegjësisë, si dhe me sa evidentohet, mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi nga institucionet e përcaktuara në VKM nr.413 datë 27.07.2000, për mbarëvajtjen e trajtimit të problemeve të ngritura nga familjet, që u janë përmbytur tokat nga ujëmbledhësi i hidrocentralit të Fierzës. Kjo pasi, megjithëse VKM-ja e sipërcituar duke filluar nga pika 4 e vazhdim, dhe veçanërisht në pikën 10 të saj përcakton shprehimisht institucionet që duhet të zbatojnë këtë vendim, përsëri ende sot, sikurse na rezulton nga përgjigjet e dhëna, një pjesë e institucioneve shtetërore përgjegjëse e konsiderojnë çështjen jashtë fushës së tyre.
- Në përgjigjet e dhëna nuk relatohet konkretisht rasti i shtetasit Ilir Avdiaj, gjë që flet pikërisht për bazueshmërinë e konkluzionit të sipërcituar. Jo vetëm kaq, por edhe në përgjigjet e Prefektit të Qarkut Kukës, të dhëna me shkresat nr.3/1-I datë 30.03.2016 dhe nr.226/1 datë 31.03.2016, si dhe nr.266/1 datë 11.04.2016, nuk sqarohet konkretisht se, ku qëndron problemi me mostrajtimin e rastit të shtetasit Ilir Avdiaj, po thuhet përgjithësisht që ka patur mungesë të dokumentacionit për të aplikuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Në asnjë prej shkresave të dërguara si përgjigje në adresë të institucionit të Avokatit të Popullit, nuk përmendet apo del si fakt mangësia e mundshme ligjore për trajtimin e kësaj problematike, si pengesë për veprimin e kërkuar të organeve përgjegjëse të administratës publike. Ndërkohë, kompleksiteti i trajtimit të çështjes

nuk mund të jetë një justifikim i bazuar për moszgjidhjen e saj të plotë, jo vetëm për rastin e ankuesit, por për të gjitha rastet e tjera, prej mëse 22 vitesh.

- Konkretësia e munguar në dhënien e informacionit për ankesën individuale të shtetasit Ilir Avdiaj, ka nxjerrë në pah problematikën madhore që ekziston tashmë për zgjidhjen e plotë dhe sistemike të problematikës së familjeve, tokat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës.

Kjo situatë ka krijuar konfuzion dhe pasiguri edhe tek subjektet e interesuara, tokat e familjeve të të cilëve janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës. Vetë ankuesi, z. Avdiaj, por edhe subjekte të tjera që janë në këto kushte sot e kësaj dite ngrejnë pyetjen se, ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problemit të tyre, pasi aktualisht ata përcillen sa nga një institucion tek tjetri pa gjetur zgjidhje për problemin e tyre.

Në këto kushte përfundimi i vetëm që mund të nxirret është se, mosveprimi i organeve të administratës publike të ngarkuara me përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, ka sjellë këtë gjendje ku sot, pas 22 vitesh, ende nuk i është dhënë zgjidhje përfundimtare trajtimit të problematikës së familjeve, tokat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës. Padyshim që ankesa e shtetasit Ilir Avdiaj, por edhe e një sërë individësh të tjerë që i janë drejtuar institucionit tonë flet qartë për këtë gjendje të krijuar, ku individët hasin vështirësi për t'u orientuar në kërkimin e së drejtës së tyre të ligjshme dhe kur organet e administratës publike nuk marrin përsipër përgjegjësitë përkatëse ligjore.

Veç aspektit administrativ që analizohet më sipër nuk duhet të harrojmë edhe një element tjetër, që nuk mund dhe nuk duhet të neglizhohet në këtë rast. Zvarritja e theksuar kohore në marrjen e vendimeve rast pas rasti, për zgjidhjen e problematikës së familjeve tokat e të cilave janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës, është një dëm që administrata publike i ka shkaktuar subjekteve përkatëse të interesuara dhe që vazhdon t'ju shkaktojë, çdo ditë që kalon.

Në këtë këndvështrim, duam t'ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21/b, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në të cilët thuhet se;

- *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit.....,*
- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË

1. Trajtimin në një kohë sa më të shpejtë të ankesës së shtetasit Ilir Avdiaj dhe marrjen e vendimit përkatës për zgjidhjen e çështjes të trajtimit të familjes së tij, prona e paluajtshme e së cilës është përmbatur nga ndërtimi i Liqenit të Hidrocentralit të Fierzës.
2. Analizimin dhe verifikimin e të gjithë rasteve dhe praktikave të ngjashme të familjeve, prona e paluajtshme e të cilave është përmbatur nga ndërtimi i Liqenit të Hidrocentralit të Fierzës, si dhe fillimin e menjëhershëm të punës për nxjerrjen e vendimeve të nevojshme për trajtimin e familjeve ende të patrajuara deri më sot.
3. Përfundimin e plotë të këtij procesi, që rezulton në tejkalim të çdo limiti kohor ligjor, të nevojshëm për fillimin dhe përfudimin e procesit të vendimmarrjes administrative, rast pas rasti.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI